

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për t razira nëse....
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/me-16-shtator-parashikohet-mbi-1-milione-qytetare-ne-pri-shtine-pritet-vendimi-i-hages-ka-dyshime-per-trazira-nese/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:32:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:29:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9e62df19166b4c5c31d24ecf31ce3fcd4b44109714968445fc27420cf3602f0
TEKSTI	eef2ec0105ad4e2549bfd70bdb69e7db1e40a5212cd4f2628021fce37ee605c
PAMJA	300a9b6a833c817251a471116556991dc154f712683c12c2aba1ac864219af6e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d9a9db46297577dd703fac7056bc39386f208cf6fe5199aa1570fe9e8f632a49
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d9a9db46297577dd703fac7056bc39386f208cf6fe5199aa1570fe9e8f632a49>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për trazira nëse....

AKTUALITET KOSOVA KRYESORE E HËNË, 14 SHTATOR 2026 20:29



Më 16 shtator, sytë e gjithë botës shqiptare do të drejtohen nga Haga dhe Prishtina.

Dhomat e Specializuara kanë caktuar shpalljen e vendimit të shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.



Në Prishtinë pritët një tubim jashtëzakonisht i madh në mbështetje të ish-drejtesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Flitet se pjesëmarrja mund të arrijë deri në një milion shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe diaspora. Por kjo shifër mbetet ende e pakonfirmuar zyrtarisht.

Megjithatë, një gjë është e sigurt: atmosfera në Kosovë është e elektrizuar.

Për shumicën dërrmuese të shqiptarëve, Hashim Thaçi dhe bashkëluftëtarët e tij luftën për lirinë e Kosovës. Ata kanë mohuar akuzat, ndërsa prokuroria ka kërkuar dënime deri në 45 vjet burg.

Një vendim dënimi, veçanërisht nëse parashikon shumë vite burg, mund të shkaktojë një tronditje të fortë emocionale dhe politike në Kosovë.

Ka informacione dhe paralajmërime jozyrtare se një vendim i tillë mund të pasohet nga tensione dhe trazira në Prishtinë.

Këto informacione nuk duhen shpërfillur, por as nuk duhet të përdoren për të mbjellë panik. Institucionet e Kosovës duhet të marrin të gjitha masat për garantimin e sigurisë, pa cenuar të drejtën e qytetarëve për të protestuar.

Policia duhet të jetë në shërbim të rendit dhe jo të provokimit. Nga ana tjetër, organizatorët e tubimit mbajnë një

LAJMET KRYESORE



Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin, në 17 shtator mbaron episodi i tensionuar



Terhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie



Mos i përdorni fëmijët e shkollave për mitingje dhe luftë politike!



Trump kundërshtoi rregullimin e AI, sulmon CEO-n e Anthropic, Dario Amodei


TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spalletti dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

përgjegjësi historike.

Ata duhet të garantojnë që çdo reagim të mbetet paqësor, dinjitoz dhe kombëtar. Një milion shqiptarë të bashkuar në shesh do të ishin një mesazh shumë më i fuqishëm sesa një grup njerëzish që përplasen me policinë apo dëmtojnë institucionet.

Çdo akt dhune do ta largonte vëmendjen nga procesi ndaj drejtuesve të UÇK-së dhe do t'u jepte kundërshtarëve të Kosovës pamjet që kërkojnë.

Serbia dhe propaganda e saj do të përpiqeshin ta paraqisnin Kosovën si një shtet të paqëndrueshëm dhe shqiptarët si një popull që nuk respekton drejtësinë.

Kosova nuk duhet t'ua japë këtë mundësi. Zemërimi mund të jetë i madh, por përgjigjja duhet të jetë politike, juridike dhe demokratike.

Edhe në rast të një vendimi dënimi, procesi nuk përfundon më 16 shtator. Mbrojtja ka të drejtën e ankimit dhe beteja ligjore do të vazhdojë.

Prandaj, kjo ditë duhet të shndërrohet në një demonstrim madhështor të solidaritetit shqiptar, jo në një natë dhune.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë nevojë për mbështetjen e popullit të tyre, por jo për trazira që mund ta dëmtojnë Kosovën.

Ata luftuan që Kosova të ishte e lirë, demokratike dhe e orientuar nga Perëndimi. Askush nuk ka të drejtë ta përdorë emrin e tyre për të sulmuar shtetin e Kosovës.

Më 16 shtator do të sprovohet jo vetëm drejtësia e Hagës, por edhe pjekuria politike e Prishtinës.

Drejtuesit politikë duhet të lënë mënjane ndasitë dhe të dalin me një mesazh të përbashkët: mbështetje për çlirimtarët dhe zero tolerancë ndaj dhunës.

Kosova ka të drejtë të protestojë. Shqiptarët kanë të drejtë ta kundërshtojnë një vendim që e konsideron të padrejtë. Por askush nuk duhet të lejohet ta kthejë protestën në kaos.

Më 16 shtator, Prishtina duhet të dëshmojë se është kryeqyteti i një shteti evropian.

Një det njerëzish, flamujsh dhe zërash paqësorë do të trondiste ndërgjegjen ndërkombëtare shumë më tepër se çdo gur apo përplasje.

Mesazhi duhet të jetë i qartë dhe i fuqishëm: Drejtësi për Hashim Thaçin dhe drejtuesit e UÇK-së! Por asnjë trazirë që mund ta plagosë Kosovën.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



FOTO/ Kardinali Ernest Simoni kremton në Amerikë meshën në gjuhën shq...



Spiro Koçi nis misionin diplomatik në Sarajevë, i paraqet letrat kred...



Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin, në ...



Tërhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbës...



Shqipëri-Kroaci, të rinjtë bashkojnë vizionin për Evropën



Ministri Jaupaj: Investitorët sauditë, interes për energjinë e rinovu...

LAJMET E FUNDIT





Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për trazira nëse…

58 SEKONDA MË PARË



107 ditë protestë, qytetarja: Më mirë shpërndajmë Parlamentin sesa kthejmë Shqipërinë në Palestinë

9 MINUTA MË PARË



FOTO/ Kardinali Ernest Simoni kremton në Amerikë meshën në gjuhën shqipe: Burri ta dojë gruan ashtu siç Krishti e des...

28 MINUTA MË PARË

Krenar Ahmeti dënon dhunën policore në protesta: Brutaliteti është i papranueshëm

26 MINUTA MË PARË

Berisha: Para administratës Trump dhe Kongresit në Amerikë, paraqita të vërtetën mbi narkoshtetin e Ramës

28 MINUTA MË PARË

Rama në Napoli për inaugurimin e Konsullatës së Nderit të Shqipërisë

29 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.